

URDHËR
Nr.21, datë 13.6.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 10, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË
FINANCIVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “AL
HARAMANIA”, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË
TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.9258 date 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit” i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.10, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “Mbi evidentimin e pasurive sipas pikave 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri dhe transaksionet”.

2. Fjala e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:

“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, aktivitetet e tjera, si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004 subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode